

ORGANIZATAT JO FITIMPRURËSE DHE PARANDALIMI I FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

UDHËZUES PËR ORGANIZATAT JO-FITIMPRURËSE



Përmbajtja

KUPTIMI DHE PËRDORIMI I UDHËZUESIT	3
Qëllimi	3
Si mund të keqpërdoren OJF-të nga organizatat terroriste?	3
Pse organizatat terroriste synojnë OJF-të?	4
Pse kjo çështje është e rëndësishme për OJF-të?.....	4
SHKALLA E EKSPOZIMIT NDAJ RREZIKUT DHE MARRJA E MASAVE BAZUAR NË NIVELIN E RISKUT	5
Pse ndërgjegjësimi i OJF-ve për rrezikun e keqpërdorimit nga terroristët është i rëndësishëm për Shqipërinë?.....	5
PARIMET DHE PRAKTIKAT MË TE MIRA.....	6
Vështrim i Përgjithshëm	6
Ndërgjegjësimi ndaj rrezikut	6
Kujdesi Paraprak.....	7
Përgjegjësia dhe transparenca	7
Përdorimi i Palëve të Treta.....	8
Detyrimi për të njohur përfituesit e shërbimeve	10
Situatat e urgjencës.....	10
Fjalorth me termat dhe shprehjet kryesore	10

KUPTIMI DHE PËRDORIMI I UDHËZUESIT

Ky udhëzues nuk është një dokument ligjor. Ai shërben si një udhërrëfyes për OJF-të që t'i ndihmojë ato të veprojnë në përputhje me legjislacionin kombëtar për parandalimin e financimit të terrorizmit dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.

Praktikat më të mira ndërkombëtare, nga ana e tyre, nuk janë veçse parime dhe politika të organizimit të brëndshëm të OJF-ve, të cilat bazohen në përvojëndhe problematikën që rrjedh nga ekspozimi i sektorit ndaj riskut të financimit të terrorizmit.

Qëllimi

OJF-të janë të ekspozuara ndaj një rreziku potencial për t'u keqpërdorur nga individë apo organizata të tjera për financimin ose mbështetjen e veprimtarisë terroriste gjë që mund të ketë pasojat të rënda për OJF-të, përfshirë dhe sanksione penale.

Ky udhëzues ka për qëllim;

- Të rrisë nivelin e ndërgjegjësimit të OJF-ve mbi këtë rrezik;
- Të paraqesë disa nga eksperiencat më të mira në nivel ndërkombëtar që OJF-të mund t'i zbatojnë për të ndihmuar në uljen e këtij rreziku;
- Të ndihmojnë OJF-të për të kuptuar dhe zbatuar kërkesat ligjore në lidhje me parandalimin e financimit të terrorizmit;

Si mund të keqpërdoren OJF-të nga organizatat terroriste?

Aktivitetet terroriste kërkojnë mbështetje financiare. Një mënyrë e sigurimit të kësaj mbështetjeje është edhe nëpërmjet mbledhjes së fondeve që në dukje janë të destinuara për qëllime humanitare, një aktivitet që zhvillohet tipikisht nga OJF-të..

Ka disa mënyra se si mund të realizohet një gjë e tillë. Këtu përfshihet sigurimi i granteve nga donatorët të cilët financojnë për çështje të ndryshme, mbledhja publike e fondeve që i lejohet një OJF-je, depërtimi brënda një OJF-je i terroristëve (pa dijeninë e personelit apo donatorëve etj).

Disa organizata terroriste në botë kanë krijuar "*organizata fasadë*" që ofrojnë ose pretendojnë se ofrojnë shërbime humanitare dhe bamirësie. Veprimtari të këtij lloji i ndihmojnë organizatat fasadë për të rekrutuar anëtarë për çështjen e tyre duke shfrytëzuar emrin e mirë të krijuar në komunitete nëpërmjet veprimtarisë bamirëse.

Këto organizata, që janë kryesisht OJF, mund të kërkojnë ndihmën e OJF-ve të tjera për të mbledhur fonde ose mund të angazhohen nga OJF-të e tjera si nënkontraktues për të siguruar

shërbime në terren. Organizata fasadë mund të përcjellë një pjesë ose të gjitha fondet e marra nga OJF-të e tjera për veprimtari terroriste.

Pse organizatat terroriste synojnë OJF-të?

Terroristët mund të synojnë të përdorin OJF-të për qëllimet e tyre, për arsytet e mëposhtëme:

- OJF-të gëzojnë besimin e publikut;
- OJF-të mund të kenë qasje në burime të konsiderueshme dhe të ligjshme financiare;
- OJF-të shpesh përdorin valute të cilat mund të tregtohen globalisht;
- Disa OJF kanë një prezencë globale që ofron një kuadër për operacionet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe transaksionet financiare;
- Disa OJF, për vetë natyrën e tyre, mund të punojnë brënda ose pranë atyre zonave që janë më të ekspozuara ndaj veprimtarisë terroriste, dhe
- OJF-të, në disa raste, nuk janë objekt i mbikqyrjes nga institucionet shtetërore;

Pse kjo çështje është e rëndësishme për OJF-të?

Pasojat që rrjedhin nga përfshirja me ose pa dijeni në mbështetjen/financimin e terrorizmit mund të përfshijnë humbjen e statusit si organizate jofitimpruese, të reputacionit dhe besimit të donatorëve.

Individët që menaxhojnë OJF-të ose edhe vetë OJF-të, mund të përballen me dënime penale (përgjegjësia penale e personave juridik është tashmë e parashikuar në legjislacionin Shqipëtar), në qoftë se ata ofrojnë mbështetje financiare për një terrorist, organizatë terroriste apo akt terrorist.

Kodi Penal Shqiptar parashikon dënime penale për sigurimin e mbështetjes me dashje ose nga pakujdesia për një organizatë terroriste .

SHKALLA E EKSPOZIMIT NDAJ RREZIKUT DHE MARRJA E MASAVE BAZUAR NË NIVELIN E RISKUT

Spektori i OJF-ve është shumë i larmishëm dhe për këtë arsye shkalla e ekspozimit ndaj rrezikut të financimit të terrorizmit ndryshon në mënyrë të konsiderueshme në varësi të strukturës organizative dhe fushës së veprimtarisë së OJF-ve.

OJF-të duhet të identifikojnë rreziqet specifike për organizatën e tyre dhe mbi këtë bazë, të bëjnë një vlerësim të nivelit sipas kategorive (*p.sh. të ulët, të mesëm ose të lartë*). Ky vlerësim duhet të shërbejë si bazë për vendimarrjen e OJF-ve dhe praktikën e tyre të punës.

Niveli i riskut rritet në rastet kur një OJF manifeston karakteristikën e mëposhtme:

- vepron në vende apo zona të njohura për aktivitet terrorist;
- përdor shërbimet alternative të dërgesave të parave apo paguan për mallrat ose shërbimet kryesisht në të holla;
- angazhon individë apo organizata të tjera për të ofruar shërbimet, pa kryerjen paraprakisht të proceseve të përzgjedhjes;
- nuk është në gjendje të ushtrojë kontroll të drejtpërdrejtë mbi programet ose projektet që zbaton duke nënkontraktuar individë ose organizata të tjera.

Është e rëndësishme që OJF-të të shqyrtojnë rregullisht rreziqet që shoqërojnë veprimtarinë e tyre, sidomos në rastet kur ka ndryshime të rëndësishme në fushëveprimin e aktiviteteve të tyre.

Pse ndërgjegjësimi i OJF-ve për rrezikun e keqpërdorimit nga terroristët është i rëndësishëm për Shqipërinë?

Vendi ynë është i angazhuar për të parandaluar terrorizmin brenda territorit të tij dhe më gjërë. Shqipëria ka një detyrim ndërkombëtar për të luftuar financimin e terrorizmit, si një vend palë në Konventën Ndërkombëtare për Ndalimin e Financimit të Terrorizmit dhe në pajtim me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së kundër terrorizmit.

Shqipëria është gjithashtu anëtare e Komitetit për Masat Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (*Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës*) i cili monitoron zbatimin nga anëtarët e tij të standarteve të Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (FATF), dhe në këtë kuadër zhvillon dhe mbështet politika për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Rekomandimi Special VIII i FATF, përcakton qartë detyrimet që vendet kanë për të *"luftuar keqpërdorimin e OJF-ve me qëllim të financimit të terrorizmit"*.

Është e rëndësishme që Shqipëria të japë kontribut në uljen e mundësive për financimin e terrorizmit global, duke krijuar ndër të tjera mekanizma dhe sisteme për të mbrojtur OJF-të nga një rrezik i tillë.

PARIMET DHE PRAKTIKAT MË TE MIRA

Vështrim i Përgjithshëm

Ashtu si të gjithë personat fizikë dhe juridikë, aktiviteti i OJF-ve vëndase apo të huaja që veprojnë në Shqipëri, duhet të kryhet në përputhje me legjislacionin Shqiptar për parandalimin dhe goditjen e financimit të terrorizmit. Në këtë kontekst nuk pritet që çdo OJF, të ketë njohuri të specializuara juridike në këtë fushë dhe për rrjedhojë është e këshillueshme që për çështje të caktuara të kërkohet dhe ndihmesa e duhur ligjore.

OJF-të mund të përballen me dënime penale në qoftë se ofrojnë fonde për një palë të tretë, e cila i përdor më pas ato për qëllime terroriste.

Ndëshkimet zbatohen sipas Kartës së OKB-së dhe Kodit Penal për individët dhe organizatat të cilët, drejtpërdrejt apo tërthorazi, sigurojnë fonde apo vënë në dispozicion pasuri për një organizatë terroriste.

Ndërgjegjësimi ndaj rrezikut

OJF-të, e sidomos stafi i tyre drejtues, duhet të kuptojnë shkallën e rrezikut ndaj të cilit organizata e tyre mund të jetë e ekspozuar në lidhje me financimin e terrorizmit, dhe kur rreziku është i qartë, të marrë masat e nevojshme të natyrës parandaluese.

Kujdesi Paraprak

Në kuadrin e përmbushjes së objektivave të aktivitetit të tyre, OJF-të duhet të ndërmarrin një sërë masash për t'i paraprirë rrezikut të abuzimit për qëllime të financimit të terrorizmit ndër të cilat përfshihen:

- Njohja e përfituesve të shërbimeve që ata ofrojnë;
- Njohja e personave/palëve të treta me të cilët punojnë;
- OJF-të duhet të sigurohen që përfituesit dhe palët e treta nuk janë individë apo pjese e organizatave të listuara nga OKB;

Përgjegjësia dhe transparencja

Praktika ndërkombëtare ka treguar se OJF-të mund të krijojnë dhe aplikojnë procedura të kontrollit të brëndshëm për t'u siguruar që fondet e përfituara dhe të lëvruara prej tyre përdoren në një mënyrë që përputhet me qëllimin e deklaruar.

Procedura të tilla mund të përfshijnë:

- hartimin dhe dokumentimin e buxheteve të programeve për të gjitha shpenzimet e tyre. Këto buxhete duhet të tregojnë identitetin e atyre të cilët do të marrin fonde (*p.sh. detajet e palëve të treta dhe/ose tëpërfituesve*) dhe mënyrën sesi do të përdoren fondet;
- Mbikqyrjen e ecurisë së përdorimit të fondeve nëpërmjet raportimeve periodike;
- Pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore, të cilat japin detaje të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe mund të vihen në dispozicion të autoriteteve;
- kryerjen e auditimit të pavarur financiar për të ofruar transparencë mbi burimet e fondeve dhe përdorimin e tyre;

Disa praktika të tjera që mund të aplikohen nga OJF-të në kuadrin e rritjes së nivelit të transparencës janë:

- Përdorimi i kanaleve bankare për kryerjen e transaksioneve financiare dhe kufizimi i kryerjes së pagesave me para në dorë;
- Ruajtja dhe vënia në dispozicion të autoriteteve përkatëse, e të dhënave të mjaftueshme për transaksionet e brëndshme dhe ndërkombëtare në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

Dokumentacioni i mësipërm duhet të përmbajë ndër të tjera informacion për:

- a) qëllimin dhe objektivat e aktiviteteve të deklaruara të OJF-ve ;
- b) identitetin e të gjithë të punësuarve dhe përfshirjen e tyre të tashme dhe të mëparshme në OJF të tjera ose subjekte tregtare, dhe
- c) identitetin e personit ave që drejtojnë aktivitetin e OJF-ve.

Ky informacion duhet të jetë publik dhe të vihet në dispozicion të publikut ose drejtpërdrejt nga OJF-të ose nëpërmjet autoriteteve shtetërore kompetente.

Përdorimi i Palëve të Treta

Kur fondet janë siguruar për një palë të tretë dhe i vihen në përdorim kësaj të fundit, OJF-ja duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për t'u siguruar se pala e tretë do të veprojë në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi dhe me këto Parime të Praktikave më të mira.

OJF-të inkurajohen të marrin hapat e nevojshme për të zvogëluar rrezikun e përdorimit të fondeve për veprimtari terroriste nga një palë e tretë, përfshirë këtu:

- ndërmarrjen e hapave të duhur për të njohur donatorët e njëkohësisht dhe përfituesit e tyre;
- kërkimin e garancive nga pala e tretë (*si një parakusht për lëvrimin e fondeve apoofrimin e shërbimeve*), se nuk do të përdoren për financimin e aktiviteteve/organizatave terroriste.

Praktikisht, OJF-të duhet të bëjnë përpjekje për të mbledhur informacionin e mëposhtëm në lidhje me palët e treta. Ky proces përfshin kërkimin direkt të informacionit nga palët e treta, apo kryerjen e kërkimeve të pavarura në burimet e hapura të informacionit.

Në qoftë se pala e tretë është një individ, OJF-të duhet të kenë në dispozicion të dhënat e mëposhtme:

- a) Emri, data e lindjes dhe të dhënat e kontakteve (p.sh. numrat e telefonit, adresa postare, etj);
- b) kombësia dhe vendbanimi;
- c) emrat e personave të kontaktit të organizatave me të cilat individi punon/bashkëpunon;
- d) një deklaratë të objektit të veprimtarisë së organizatave të përmendura në pikën c;
- e) detajet e projekteve të tjera/veprimeve/iniciativave/angazhimeve të cilat është përfshirë pala e tretë - duke përfshirë informacione mbi përfituesit;
- f) dh)çdo informacion tjetër që OJF mund të sigurojë mbi identitetin dhe integritetin e palës së tretë.

Në qoftë se pala e tretë është një organizatë, OJF-të duhet të kenë në dispozicion informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin dhe detajet e kontaktit (p.sh. numrat e telefonit, adresën postare, adresën e-mail);
- b) vendi në të cilin është formuar organizata;
- c) një deklaratë të qëllimit kryesor të krijimit të tyre;
- d) dokumentet të tilla si:
 - kopje të dokumenteve ligjore të rregjistrimit,
 - informacion për personat që kanë formuar organizatën dhe punojnë në të;
 - informacion në lidhje me donatorët e organizatës;
- e) të dhënat e projekteve/veprimeve/iniciativave/angazhimeve të tjera të ndërmarra ose të kryera tashmë nga pala e tretë - duke përfshirë informacione mbi përfituesit e këtyre veprimeve, dhe

- f) çdo informacion të arsyeshëm që siguron OJF-ja për identitetin dhe integritetin e palës së tretë.

Detyrimi për të njohur përfituesit e shërbimeve

OJF-të duhet të sigurohen së kanë informacion të mjaftueshëm për përfituesit e tyre të cilëve ju ofrojnë ndihmë (*p.sh., komunitetin e fshatit, qytetit etj*) dhe të informohen në mënyrë të vazhdueshme mbi mënyrën e përdorimit të fondeve të lëvruara prej tyre.

OJF-të duhet të ndërmarrin hapat e duhur për të njohur identitetin e donatorëve të rëndësishëm duke respektuar njëkohësisht konfidencialitetin e tyre.

Informacioni personal që OJF-te marrin nga donatorët dhe përfituesit e tyre duhet të mblidhet, të përdoret dhe të ruhet në përputhje me detyrimet në kuadër të ligjeve për mbrojtjen e të dhënave.

Situatat e urgjencës

Situata të caktuara, të tilla si rastet e fatkeqësive natyrore apo urgjenca të tjera civile, mund ta bëjnë të vështirë për OJF-të mbledhjen e informacionit mbi palët e treta dhe/ose përfituesit. Megjithatë, OJF-të duhet ndër të tjera të marrin në konsideratë rreziqet që mund të shoqërojnë situatën dhe brënda kontekstit të këtij vlerësimi të riskut, të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të përcaktuar identitetin dhe integritetin e palëve të treta dhe përfituesve.

Fjalorth me termat dhe shprehjet kryesore

Pjesa në vijim shpjegon kushtet kryesore dhe frazat e përdorura në Parimet e Praktikave më të Mira.

“Të gjitha përpjekjet e arsyeshme” janë përdorur për të reflektuar nevojën për veprim pozitiv dhe një kuptim për qasje të përbashkët, bazuar në nivelin e rrezikut, për të përmbushur detyrimet ligjore dhe për të shmangur financimin e aktivitetit terrorist.

“Përfitues” i referohet atyre personave fizik, ose grupet e personave fizikë të cilët përfitojnë nga shërbimet e bamirësisë përmes shërbimeve të OJF-ve.

“Fondet” i referohet pasurive të çdo lloji ose pronë të çdo lloji, qoftë e luajtshme ose e paluajtshme, dokumentet ligjore ose instrumentet në çfarëdo forme, duke përfshirë ato elektronike ose dixhitale, që vërtetojnë tituj, ose interes në, të tilla prona ose pasuri, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, kredi bankare, çeqe të udhëtarëve, çeqet bankare, transferta parash, aksione, letrat me vlerë, obligacione, instrumente të borxhit, drafte dhe letra të kreditit.

“Individët ose organizatat e listuara” nënkupton çdo individ ose organizatë e cila shfaqet në Listën e Konsoliduar të të gjithë personave dhe entiteteve, subjekte të sanksioneve financiare të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

“Organizata jo-fitimprurëse (OJF)” është një person juridik ose organizatë që kryesisht angazhohet në grumbullimin ose shpërndarjen e fondeve për qëllime fetare, kulturore, arsimore, sociale ose për kryerjen e llojeve të tjera të *“veprave bamirëse”*. Ky përkufizim nuk është shterrues dhe një entitet apo organizatë duhet të marrë parasysh rrethanat e saj të veçanta.

Sipas natyrës një OJF mund të karakterizohet si vijon:

- organizata apo subjekti nuk ka për qëllim fitimin;
- subjekti apo organizata konsiderohet e pavarur nga shteti apo ndikimet politike të partive. Subjektit apo organizatës mund ti lindë e drejta për lehtësira fiskale sipas legjislacionit Shqipëtar;
- subjektit apo organizatës i buron mandati, apo e drejta për të ekzistuar, nga veprimet që kontribuojnë në të mirën publike ;

“Aktivitet i dyshimtë” është çdo veprimtari/aktivitet, ku një individ i njohur ose i dyshuar si terrorist është i përfshirë në një organizatë terroriste apo në financimin e akteve terroriste. Ky term përfshin, çdo aktivitet në të cilin janë përfshirë individë apo organizata të listuara nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

“Palë e tretë” është çdo individ ose organizatë tjetër veç përfituesit të cilit OJF-ja i ofron fonde apo mbështetje, ose prej të cilit OJF-ja merr fonde apo mbështetje, për të kryer funksionet e saj të zakonshme, duke përfshirë mbledhjen e fondeve dhe dhënien e ndihmës. Pala e tretë

përfshin, por pa u kufizuar në, partnerët, ndërmjetësit, kontraktorët, nën-kontraktorët dhe ofruesit e shërbimeve.